



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

## Rivlerësimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve – Raport Konsultativ

1 gusht 2011

### DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE-ja për të marrë komentet dhe qëndrimet nga palët e interesit. Dokumenti nuk duhet të konsiderohet se paraqet vendim të ZRRE-së.

## Përmbajtja

<b>1</b>	<b>Hyrje</b> .....	<b>3</b>
<b>2</b>	<b>Vlerësimi i Aseteve të Rregulluara</b> .....	<b>3</b>
2.1	Vlerësimi Financiar .....	3
2.2	Vlerësimet e Kapacitetit Operacional.....	4
<b>3</b>	<b>Vlerësimi Rregullator i Aseteve në Kosovë</b> .....	<b>4</b>
3.1	Qasja e Tanishme.....	4
3.2	Draft Regullat e Tarifave.....	5
<b>4</b>	<b>Vlerësimi i asetëve në llogaritë financiare të të licencuarve</b> .....	<b>5</b>
<b>5</b>	<b>Qasja e Propozuar</b> .....	<b>6</b>
5.1	Vlerësimi i asetëve të viteve para-2006 .....	6
5.2	Jetëgjatësia e Aseteve .....	7
5.3	Azhurnimi në vlerat e vitit 2012 .....	7
<b>6</b>	<b>Ndikimi në Tarifa</b> .....	<b>7</b>

# 1 Hyrje

Neni 43.3.6 i Ligjit të ri për Regullatorin e Energjisë kërkon që tarifat e miratuara nga ZRRE-ja, të lejojnë, në mes tjerash, kthimin e:

kostove normale të zhvlerësimit mbi të gjitha asetet e përfshira në Bazën e Aseteve të Rregulluara, dhe “Baza e Aseteve të Rregulluara” nënkupton të gjitha asetet e përdorura dhe të dobishme në ofrimin e shërbimeve nga subjekti i rregulluar, përveç asetëve plotësisht të zhvlerësuar;

“Baza e Aseteve të Rregulluara” (RAB) luan rol kyç në llogaritjen e Të Hyrave të Lejuara që do të mbulohen nga tarifat e rregulluara. Për çështje rregullative, ZRRE-ja momentalisht vlerëson të gjitha asetet e përfshira në RAB e që janë të ndërtuara para vitit 2006 me vlerë zero (arsyet paraqiten më poshtë).

Ligji i ri nuk lejon vazhdimin e kësaj qasjeje dhe, për për këtë arsye, është e domosdoshme të rivlerësohet RAB-i në përputhje me kërkesat në Ligjin e ri për Regullatorin e Energjisë. Parimet për rivlerësim duhet të formohen para shqyrtimit të ardhshëm të Të Hyrave të Lejuara dhe Tarifave të rregulluara, që pritet të përfundojë në fund të muajit mars të vitit 2012.

Ky Raport Konsultativ publikohet që të paraqesë propozimin e ZRRE-së mbi trajtimin e Aseteve dhe vlerës së RAB. që të paraqes opsionet të cilat janë duke u marrë parasysh nga ZRRE-ja, duke l'u referuar qasjeve alternative të rivlerësimit. Komentet mund të dërgohen deri me 15 gusht 2011, përmes postës elektronike në adresën [ero.pricing-tariffs@ero-ks.org](mailto:ero.pricing-tariffs@ero-ks.org), me titull “Komente në Rivlerësimin e RAB-it ” apo të dërgohen me shkrim në adresën e Zyrës së Regullatorit për Energji me mbishkrimin “Departamenti për Tarifa dhe Çmime”.

## 2 Vlerësimi i Aseteve të Rregulluara

Ekziston një numër i qasjeve alternative për vlerësimin e asetëve të ndërmarrjeve të rregulluara. Më së thjeshti, këto metoda mund të ndahen në kategoritë e vlerësimit të kapaciteteve financiare dhe operacionale.

### 2.1 Vlerësimi Financiar

Qasja e vlerësimit financiar fokusohet në kthimin e shpenzimeve të asetëve të investitorëve. Sipas këtij koncepti, vlerësimet më të përshtatshme janë:

- Për asetet për të cilat pronësia mbetet e pandryshueshme, kostot aktuale historike të këtyre asetëve paraqesin pagesat që janë realizuar për ato.
- Për asetet për të cilat pronësia ka ndryshuar, çmimi i shitjes (d.m.th për kompanitë që janë privatizuar vlera e transaksionit) e cila paraqet vlerën që pronari i ri ka paguar për ato asetë.

Poashtu, ekziston mundësia që të futet vlera e asetëve të pronari i tyre ( d.m.th. vlera e tregut) duke diskontuar rrjedhen e parasë së ardhshme në mënyrë të drejtpërdrejtë nga aset.

### 2.2 Vlerësimet e Kapacitetit Operacional

Qasja e vlerësimit të kapacitetit operacional, ndryshe nga ajo e vlerësimit financiar, fokusohet në reflektimin e kostove të tanishme të asetëve. Kjo realizohet duke i vlerësuar asetet me kostot e zëvendësimit të tyre. Më saktësisht, kostot e optimizuara të zëvendësimit duhet të përdoren me largimin e asetëve të panevojshme nga baza e asetëve. Meqë rivlerësimet e shpeshta të kostove të zëvendësimit nuk janë praktike, rekomandohet që në vend të tyre të indeksohen vlerat e asetëve deri në një matje të ndryshimit në kosto.

Rivlerësimi i kostove të zëvendësimit mund të rezultojë në vlera më të larta apo më të ulta të asetëve se sa me përdorimin e kostove historike. Kur progresi teknologjik është i shpejtë, dhe asetet janë me jetëgjatësi të shkurtër, atëherë është e mundur që aset i ri të ketë mundësi të performojë në të njëjtin nivel me asetin ekzistues, por me kosto më të ulëta.

## 3 Vlerësimi Rregullator i Aseteve në Kosovë

Një përmbledhje e metodologjive të vlerësimit të asetëve të përdorur nga ZRRE-ja, dhe ato të cilat janë në draft Rregullat e Tarifave të cilat janë duke u punuar për përfshirjen e kërkesave nga Ligji i ri, paraqitet më poshtë, krahas një përshkrimi të shkurtër të arsyeve të këtyre qasjeve.

**Tabela 1: Metodologjitë e vlerësimit të RAB-it të aplikuara në Kosovë**

	Data asetëve		
	Para vitit 2006	2006-11	2012 e tutje
<b>Qasja e tanishme</b>	Zero	Kostoja aktuale historike	
<b>Draft Rregullat për Tarifa</b>	<i>në bazë të konsultimit</i>	<i>në bazë të konsultimit</i>	<i>Kosto e miratuar, indeksuar me CPI</i>

### 3.1 Qasja e Tanishme

Asetet e ndërtuara para vitit 2006 vlerësohen në zero për çështje rregullatore, duke u bazuar në atë se të licencuarit (KEK-u dhe KOSTT-i) nuk kanë pasur shpenzime lidhur me blerjen e këtyre asetëve. Prandaj, është konsideruar që lejimi i të licencuarve të përfitojnë zhvlerësim dhe kthim të lejuar nga këto asete do të implikonte një fitim të lartë për të licencuarit dhe rritje të menjëhershme të tarifave. Të licencuarve u lejohet që të mbulojnë kostot e mirëmbajtjes dhe kostot e operimit të

këtyre aseteve. Kostoja e zëvendësimit të investimeve është shtuar në RAB në datën kur kjo kosto është realizuar.

Synimi fillestar i ZRRE-së ka qenë që të ketë shqyrtime shumë-vjeçare të çmimeve. Me këtë qasje, asetet e ndërtuara pas vitit 2006 do të futeshin në RAB me vlerën e tyre aktuale dhe pastaj do të indeksoheshin për inflacion. Kjo do të ruante në mënyrë të gjerë vlerën reale financiare të këtyre aseteve. Për t'ju shmangur numërimit të dyfishtë, të licencuarit do të fitonin kthim në këto asete duke llogaritur shpenzimet reale kapitale (pasi që do të kompenzoheshin për ndikimin e inflacionit me anë të indeksimit të RAB-it). Përdorimi i kostove të realizuara është adaptuar në mënyrë që të krijojë nxitje për të licencuarit që të kenë rezultate në programet e tyre të propozuara të investimeve.

Pastaj, kur ZRRE-ja ka miratuar shqyrtimet e përkohshme njëvjeçare për arsye të mungesës së disponueshmërisë dhe besueshmërisë të të dhënave, është vendosur që të kalohet në përdorimin e vlerësimeve historike të shpenzimeve për asetet e përfshira në RAB për shkak të thjeshtësisë. Llogaritja e kthimit të lejuar është azhurnuar me përdorimin e kostove kapitale nominale.

### 3.2 Draft Regullat e Tarifave

Sipas draft rregullave për tarifa do të aplikohet shqyrtimi shumë-vjeçar i çmimeve. Njejtë si në metodologjinë ekzistuese të ZRRE-së për shqyrtime shumë-vjeçare, RAB-i do të indeksohet për inflacion dhe kthim të lejuar, dhe do të llogaritet duke përdorur kostot reale të kapitalit.

Ndryshe nga metodologjia ekzistuese, asetet do t'i shtohen RAB-it në vlerën e lejuar të kostos së investimit dhe jo në vlerën e realizuar të kostos së investimit. Kjo ka për qëllim nxitjen e investitorit që kostot e investimeve t'i bëjë në mënyrë efikase, duke ju lejuar që të mbajnë ndryshimin në mes të kostove të realizuara dhe atyre të lejuara.

## 4 Vlerësimi i aseteve në llogaritë financiare të të licencuarve

Parimet e kontabilitetit të aplikuara nga KEK-u (bartës i licencës për OSSH dhe për Furnizim Publik me Energji Elektrike si dhe si pronar dhe operator i gjeneruesve të Kosovës A dhe B dhe ndërmarrjes së Minierave) janë si në vijim:

- Asetet fikse më 1 janar 2005 paraqiten si kosto të deklaruara minus zhvlerësimi dhe dëmtimi<sup>1</sup>
- Kostoja e deklaruar është vlera e këtyre aseteve sipas vlerësuesit të pavarur gjatë vitit 2005. Rivlerësimi paraprak është realizuar gjatë vitit 2002.

---

<sup>1</sup> Dëmtimi<sup>1</sup> - rregullimi i vlerës së aseteve për shkakë të dëmtimit

## Qasja e Propozuar

- Dëmtimi aplikohet kur vlera e rikuperueshme e asetit është më e vogël se vlera e mbajtjes së atij asetit (e rivlerësuar apo kostoja aktuale). Vlera e rikuperueshme e asetit është vlera më e madhe në mes të vlerës neto të shitjes (esencialisht vlerës së mbetur) dhe vlerës në përdorim. Vlera në përdorim përcaktohet nga rrjedha e parasë e gjeneruar nga ai aset.
- Asetet Fikse të blera pas 1 janarit 2005 janë paraqitur në kostot aktuale (historike) minus zhvlerësimi dhe dëmtimi.

Asetet e transferuara në KOSTT në themelimin e tij në vitin 2006, janë përfshirë në llogaritë statutorë të KOSTT-it me vlerën e transferit të tyre. Kjo paraqitje ka marrë parasysh koston e deklaruar, të cilës i është zbritur zhvlerësimi dhe dëmtimi. Pastaj, asetet e reja janë shtuar duke ndjekur qasje të njëjta me KEK-un.

Një përmbledhje e qasjes së vlerësimit të asetëve në llogaritë statutorë financiare të të licencuarve paraqitet më poshtë.

**Tabela 2: Vlerësimi i asetëve në llogaritë financiare të të licencuarve**

	Data e asetëve		
	Para-2006	2006-11	2012 e tutje
<b>Llogarit Financiare</b>	Kostoja e dëmtuar e zëvendësimit	Kostoja aktuale historike	Kostoja aktuale historike

## 5 Qasja e Propozuar

Qasja e vlerësimit të asetëve varet nga kufizimet praktike.

### 5.1 Vlerësimi i asetëve të viteve para-2006

Në përcaktimin e vlerës fillestare të asetëve të viteve para-2006, mënyra e vetme praktike duket të jetë përdorimi i vlerës së paraqitur në llogaritë statutorë të të licencuarve si më 1 janar 2006. Këtu paraqiten kostot e zëvendësimit të atyre asetëve, të vlerësuara në vitin 2005.

Vlerësimet alternative të kostove financiare konsiderohen të jenë joreale:

- Vlerat historike të kostove të asetëve nuk janë në dispozicion, pas rivlerësimit të asetëve në vitin 2002 dhe 2005. Nuk do të ishte praktike të kërkohej të rikonstruktohen rivlerësimi edhe për vlera historike. Për më tepër, siç është diskutuar më lart, nuk ka kosto aktuale financiare të ndërlidhur me këto asetë, dhe nuk ka lidhje ndërmjet kostove historike të këtyre asetëve, të regjistruara në llogaritë financiare statutorë, dhe kostove të realizuara të blerjes së tyre nga të licencuarit.

## Ndikimi në Tarifa

- Vlerësimi i bazuar në rrjedhën e parasë sipas tarifave të tanishme po ashtu nuk do të ishte praktik. Këto tarifa janë caktuar duke u bazuar në atë se asetet e viteve para-2006 vlerësohen në zero për çështje rregullative. Futja e vlerës për këto asete bazuar në parashikimet e rrjedhës së parasë së gjeneruar nga to do të implikonte logjikisht që vlera e tyre të jetë zero.

Po ashtu, nuk do të ishte praktike të komisionohej një studim i ri për të rivlerësuar asetet duke përdorur kostot e zëvendësimit, kur kemi parasysh kohën dhe kostot e nevojshme.

### 5.2 Jetëgjatësia e Aseteve

Është poashtu e domosdoshme të përcaktohet jetëgjatësia e duhur e cila do të aplikohet për asetet e ndërtuara para vitit 2006. Për shkak të konsistencës propozohet që kjo të jetë e njëjtë sikurse jetëgjatësinë e asetëve të miratuar nga ZRRE-ja për t'u aplikuar për asetet e ngjashme të reja. Asetet e ndërtuara para vitit 2006 janë pjesërisht të zhvlerësuar. Si në deklaratimet e 1 janarit 2006, zhvlerësimi i akumuluar i këtyre asetëve paraqet 21% të vlerës së tyre bruto (para dëmtimit), e cila lë të nënkuptohet se kjo pjesë e jetëgjatësisë së tyre tashmë ka skaduar.

Për këtë arsye, është e nevojshme që asetet e ndërtuara para vitit 2006 të zhvlerësohen për pjesën e mbetur të jetëgjatësisë së tyre. Sa për të ilustruar këtë llogaritje, supozojmë se jetëgjatësia standarde e një aseti është 30 vite. Më 1 janar 2006, jetëgjatësia e mbetur e asetëve të ndërtuara para vitit 2006 është 79% (proporcioni i vlerës bruto që nuk është zhvlerësuar). Kjo është ekuivalente me 24 vite (duke e rrumbullakësuar vitin më të afërt). Lejimi i zhvlerësimit vjetor në këtë rast do të jetë 1/30 e vlerës bruto të aplikuar për periudhën 24 vjeçare (e cila duhet të arrijë vlerën neto në zero).

### 5.3 Azhurnimi në vlerat e vitit 2012

Pas vlerësimit të vlerës së asetëve të ndërtuara para vitit 2006, do të jetë e domosdoshme që kjo të aplikohet në RAB-in e vitit 2012, që do të përdoret për llogaritjen e shqyrtimeve të ardhshme tarifore. Për të qenë konsistent me draft Rregullat për Tarifa, është e nevojshme që, në mes të Shqyrtimeve Periodike, RAB-i të azhurnohet për të reflektuar ndryshimet në inflacion.

## 6 Ndikimi në Tarifa

RAB-i i përdorur për të llogaritur zhvlerësimin për KEK-un në tërësi, për vitin 2011, është aplikuar duke përdorur supozimet vijuese:

- RAB-i në 1 janar 2006 është i barabartë me vlerën e rivlerësuar të asetëve, përfshirë edhe dëmtimin. Kësaj vlere i zbriten asetet e transferuara në KOSTT.
- Prej 2006 deri me 2009, asetet janë shtuar në RAB me vlerën e tyre aktuale të raportuar nga llogaritë statutorë të KEK-ut. Në të njëjtën mënyrë, shitja e asetëve është marrë nga llogaritë statutorë.

## Ndikimi në Tarifa

- Asetet e financuara nga grantet (të identifikuar si donacione në llogaritë statutores) i janë shtuar RAB-it .
- Për vitet 2010 dhe 2011, shtesat e supozuara në RAB janë ekuivalente me ato të raportuara nga KEK-u për vitin tarifor 2010-11 dhe të miratuara nga ZRRE-ja për vitin tarifor 2011-12 respektivisht në shqyrtimin e pestë të tarifave të energjisë elektrike (SHTE5).
- RAB-i është indeksuar me vlerën e CPI-së së muajit dhjetor në Kosovë. Për vitin 2011, kjo vlerë është supozuar të jetë e njëjtë me atë të dhjetorit të vitit 2010.
- Zhvlerësimi është llogaritur me metodën lineare duke përdorur jetëgjatësinë mesatare të aseteve prej 30 vitesh (jetëgjatësia mesatare e aplikuar nga ZRRE-ja në të gjitha divizionet e KEK-ut është ndarë proporcionalisht me pjesëmarrjen e tyre në RAB-in total).

Një qasje e njëjtë është aplikuar për ta përcaktuar RAB-in për KOSTT-in, duke përdorur vlerën fillestare të 1 Janarit të vitit 2006 të vlerës së aseteve të transferuara nga KEK-u në KOSTT në korrik të vitit 2006. Në llogaritë e tyre financiare, KOSTT-i ka përdorur vlerën neto të librave të aseteve të transferuara si vlerë fillestare të bazës së asetit (vlerën pas zhvlerësimit dhe dëmtimit). Kjo në mënyrë të qartë paraqet jokonsistencë me qasjen e aplikuar për KEK-un, prandaj, ne kemi rillogaritur vlerën bruto fillestare të RAB-it të KOSTT-it, si vlerë bruto të aseteve të transferuara nga KEK-u te KOSTT-i. Kjo paraqet vlerën e mundshme maksimale fillestare të RAB-it dhe do të ishte në rregull të zvogëlohet në mënyrë që të barazohet me vlerën fillestare të aseteve në llogaritë e KOSTT-it, sipas regjistrimit të tyre.

Për KOSTT-in, jetëgjatësia mesatare prej 35 vitesh është aplikuar njëjtë si në supozimet e tanishme rregullatore të ZRRE-së. Shtesat aktuale të regjistruara në llogaritë financiare të KOSTT-it janë në dispozicion dhe janë përdorur në këtë llogaritje.

Për KEK-un dhe KOSTT-in, vlera fillestare e  $RAB_t$ , e përdorur që të llogaritet kthimi i lejuar, është caktuar si zero si më 1 janar 2006. Në vitet vijuese,  $RAB_t$  është rritur duke i shtuar asetet të cilat nuk janë financuar nga grantet. Kjo vlerë fillestare nënkupton se asetet para vitit 2006 janë të financuara nga grantet dhe, në këtë rast, të licencuarit nuk kanë kosto të asociuara të financimit të tyre. Për shmangien e dyshimit, për qëllime të zhvlerësimit asetet janë paraqitur me vlerë pozitive në RAB.

Sipas këtyre supozimeve, vlera neto e bartur e RAB-it për KEK-un me 31 dhjetor 2011 do të jetë €500 milionë (bazuar në dëmtim) krahasuar me €363 milionë e llogaritur në SHTE5 e cila është bazuar në metodologjinë e tanishme. Për KOSTT-in, vlera neto e bartur e RAB-it do të jetë €123 milionë krahasuar me €80 milionë e cila është e llogaritur me metodologjinë e tanishme.

Vlerat rezultuese të zhvlerësimit sipas propozimit të ZRRE-së paraqiten më poshtë. Këto janë krahasuar me zhvlerësimin dhe kthimin e lejuar të llogaritura nga ZRRE-ja si pjesë e miratimit të tarifave në SHTE5. Llogaritja e kthimit të lejuar përdor koston reale të kapitalit përderisa kthimi i

## Ndikimi në Tarifa

lejuar në SHTE5 është llogaritur duke përdorur koston nominale të kapitalit. Tabela po ashtu tregon rritjen në të Hyra të Lejuara krahasuar me Të Hyrat e Lejuara të SHTE5.

**Tabela 3: Rivlerësimi i RAB-it (2011) dhe ndikimi në tarifa**

€000s nëse nuk shprehet	Propozimi		SHTE5	
	KEK	KOSTT	KEK	KOSTT
Zhvlerësimi	30 769	3 963	15 392	2 059
Baza për kalkulim	Dëmtimi i RAB		n/a	
Kthimi I lejuar	24 129	1 468	33 544	1 302
Baza për llogaritje	RAB <sub>f</sub> i vendosur zero në 1 janar 2006		n/a	
<b>Totali i kostove kapitale</b>	<b>54 897</b>	<b>5 432</b>	<b>48 937</b>	<b>3 361</b>
	<b>60 329</b>		<b>52 297</b>	
	<b>Rritja në të Hyrat e Lejuara të SHTE5</b>			
	4%		n/a	